



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade

RAPORT NGA PROCESI I KONSULTIMIT PËR
KONCEPT DOKUMENTIN PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E LIGJIT
PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

Hyrja/sfondi

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, respektivisht Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit në cilësinë e Organit Propozues të Koncept Dokumentit për plotësim ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit, ka propozuar hartimin e këtij dokumenti me qëllim të përmirësimit dhe përditësimit të parimeve të së drejtës për mbrojtjen e konsumatorit. Draft-Koncepti për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit është dokument i rëndësishëm, i cili në qendër të tij vë konsumatorët, ndërsa si pikë reference Programin për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Në parim, arsye-shëmëria për hartimin e këtij draft-Koncepti është fuqizimi i konsumatorit për rol aktiv në treg, që ushtron të drejtat dhe fuqinë e tij/saj të zgjedhjes së mirë-informuar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve të pranuar. Politikat e mirëfillta të hartuara dhe të zbatuara për mbrojtjen e konsumatorëve i mundësojnë atyre të bëjnë zgjedhje të mirë-informuara, duke ndikuar pozitivisht në krijimin e një konkurrence të ndershme dhe rritje të qëndrueshme. Kështu, plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit synon që konsumatorët të fuqizohen dhe të luajnë rol aktiv në treg, gjë që kërkon forcimin e besimit të konsumatorëve në blerjen e mallrave dhe shërbimeve.

Bazuar në Rregullores nr.09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, më datë 30.07.2021, autoritetet administrative kompetente në MINT, kanë dërguar draft koncept dokumentin në Konsultim të gjitha institucioneve palë të interesit, që t'ju ofrojmë informata atyre dhe për publikun, e në veçanti me qëllim që të merret mendimi i tyre dhe i publikut rreth konceptit në fjalë.

Ministria Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, respektivisht Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit në draft dokumentin përkatës ka identifikuar dispozita në Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit, të cilat nuk mbështeten nga masa adekuate administrative dhe/ose dispozitat e nevojshme penale. Pra, në rend të parë, qëllimi i konceptit është mbështetja e Ligjit aktual për Mbrojtjen e Konsumatorit me dispozita të veçanta dhe / apo masa të nevojshme/duhura administrative ose dispozita penale, për te arritur kështu një efikasitet të plotë të kornizës legjislative të mbikëqyrjes së tregut në fushën e mbrojtjes së konsumatorit.

Draft koncept dokumenti, gjithashtu identifikon nevojën mbi harmonizimin e mëtutjeshëm me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni Evropian prej se është miratuar Ligji aktual ne fuqi 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit në vitin 2018. Komisioni i BE-së propozoi të fillojë një seri reformash / përmirësimesh në fushën e mbrojtjes së konsumatorit në BE, që eventualisht u kurorëzua me hartimin e Direktivës për zbatimin dhe modernizimin më të mirë të mbrojtjes së konsumatorit (BE / 2019/2161).

Së fundmi, koncept dokumenti për plotësim ndryshimin Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit, ka mundur të identifikoj mangësitë dhe/apo mospërshtatjet e Legjislacionit dhe rregulloreve vendore ekzistuese ndaj kushteve të reja të biznesit, të cilat mund të përbëjnë më tutje një pengesë të konsiderueshme në zhvillimin e tregtisë dhe atë të përgjithshëm ekonomik në R. e Kosovës. Në këtë kontekst, përpos ligjeve tjera që afektojnë drejtpërdrejt fushën e tregtisë, aktuale dhe me rëndësi të veçantë, tash e disa vite, shohim nevojën për zhvillimin e tregtisë elektronike.

Ecuria e procesit të konsultimit

Duke pasur parasysh se procesi i konsultimeve është realizuar dhe është zhvilluar komfor rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren për Punën e Qeverisë nr. 09/2011,

Rregulloren Nr. 05/2016 Për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, Udhëzuesin për procesin e konsultimeve Nr.062/2011 dt. 26.09.2011, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si organ propozues i këtij akti ligjor, ka zhvilluar procesin e konsultimeve paraprake dhe publike në të cilën periudhë e ka dërguar në Konsultim të gjitha institucionet përkatëse dhe palët e interesit, që t'ju ofrojë informata për publikun e në veçanti për grupet e interesit, me qëllim të merret mendimi i publikut dhe grupeve të interesit rreth hartimit të këtij Koncept Dokumenti.

Duke pasur parasysh se procesi i konsultimeve është realizuar dhe zhvilluar komfor rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Rregulloren për Punën e Qeverisë nr. 09/2012, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë gjatë kësaj periudhe ka pranuar komente lidhur me Koncept Dokumentin për plotësim ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit, nga 'Agjencia për Barazi Gjinore' në kuadër të Kryeministrisë me datën 16.08.2021, nga 'Shoqata e Shitësve me Pakice me datën 06.09.2021, si dhe nga OJQ 'INDEP' me datën 06.09.2021.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i pjesëmarrësve të cilet kane kontribuar	Numri i koment pranuar
1. Konsultimet me shkrim / në mënyrë elektronike;	30.07.2021 15 ditë pune			1
3. Publikimi në ueb faqe/Platforma elektronike	16.08.2021 15 ditë pune			
5. Takimet publike				
7. Konferencat				
9. Takime me grupe të interesit				
11. Punëtoritë				
13. Intervistat/takimet sy në sy				
15. Hulumtimet e opinionit				
17. Votimi diskutues				
19. Panelet me qytetarë				
21. Stendat në rrugë				
23. tjetër				

Përmbledhje e kontributeve të pranuar gjatë procesit të konsultimit dhe kategoritë e kontribuesve

Ka pasur.

Hapat e ardhshëm

Tabela e detajuar me informatat për kontribuesit, arsyetimet për përgjigjet e pranuar dhe të refuzuara.

Emri i organizatës /individit	Koment i organizatës /individit	Përgjigja nga Ministria E pranuar plotësisht E pranuar pjesërisht E refuzuar	Sqarim nga Ministria (veçanërisht arsyet për të mos pranuar komente të caktuara)
International Advisor/UNWO MEN (Agjencia për Barazinë Gjinore në kuader të Kryeministris).	Mungojnë referencat, përfshirja, reflektimi dhe transpozimi i dispozitave të BE-së për barazinë gjinore, kornizave ligjore të Kosovës, dhe instrumenteve të tjerë të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore, si dhe instrumentave strategjikë të BE-së.	E pranuar pjesërisht	Fushëveprimi i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (06/L-34), në rend të parë përgjegjësi e DMK, rregullon (sikurse është e cekur edhe në nenin 3 të Ligjit) marrëdhëniet ndërmjet konsumatorëve nga njëra anë dhe prodhuesve, furnizuesve, shitësve apo ofruesve të produkteve apo shërbimeve nga ana tjetër, për të mbrojtur konsumatorin nga praktikat e padrejta në tregun e Republikën Kosovës (në rastin konkret pa dallim race, feje, gjinie, nacionaliteti...)! Pra,

			parimet themelore mbi të cilat ndërtohen dhe zbatohen politikat për mbrojtjen e konsumatorëve në Bashkimin Evropian dhe Kosovë, marrin shtrirje në kuadër të drejtave baze për konsumator (neni 5 i Ligjit).
International Advisor/UNWO MEN (Agjencia për Barazinë Gjinore në kuadër të Kryeministris).	Mungojnë analizat e mirëfillta dhe me perspektivë gjinore për mbrojtjen e konsumatorit.	E pranuar pjesërisht	Koncepti i barazisë gjinore veç është pjesë e (mes tjerash) të ‘drejtave të konsumatorëve’ (parimet bazë në BE), pjesë e politikës sikurse parashihet edhe me programin 2016-2020 (dhe respektivisht draft-programin 2021-2025) për mbrojtjen e konsumatorëve. Këto të drejta (veç tjerash), pastaj vijnë në shprehje përmes rregullimit dhe/apo derregullimit (sikurse e përcakton politika) në varësi të detyrave dhe përgjegjësi të dikastereve të ndryshme sikurse është edhe ai i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK).
International Advisor/UNWO MEN (Agjencia për Barazinë Gjinore në kuadër të Kryeministris).	Moszbatimi i vlerësimit të ndikimit gjinor (VNGj) sipas standarteve të përcaktuara për zbatimin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullativ dhe Vlerësimit të Ndikimit Gjinor (manualët relevante)	E pranuar pjesërisht	Në kapitullin e 4 të draft koncept dokumentit (faqe 40) ‘Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme’, si dhe në shtojcën 4 të koncept dokumentit (faqe 58) – ‘Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore’, duhet të figuroj edhe ‘vlerësimi mbi barazinë gjinore’ (sipas manualit në fjalë), çka konsideroj (apo kemi konsideruar si grup punues) se

			mbulohet (apo është mbuluar) në pikën e 2-të të shtojcës 4 të draft konceptit, dhe me q'rast është/kemi deklaruar, si grupi punues, se nuk ka ndonjë ndikim (kjo kryesisht duke u mbështetur në arsyet sikurse u potencuan në pikat e lart shenuara)!
Rrjeti i Shitësve me Pakicë.	Largimin e dispozitës për vendosjen e flamurit të origjinës (neni 16 i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit)	E pranuar pjesërisht	Largimi i dispozites në fjalë ka qenë (që nga fillimi/inicimi) dhe është edhe insistimi nga/i strukturave kompetente/prezente të BE-s në Kosove (respektivisht atyre nga Brukseli), dhe prandaj, në këtë kontekst, largimi dispozites/ave në fjal, në kontekstin e propozimit nga autoritetet e BE-s, vec se figuron si e tillë në Draft Koncept Dokument.
OJQ - INDEP	Në propozojmë që në koncept dokument, në faqe 38, tek Rekomandimet të shtohet rekomandimi Nr. 6 me përmbajtjen si në vijim: Të hiqet obligimi për vendosjen e flamurit të shtetit të origjinës pranë produkteve në përputhje me legjislacionin evropian dhe interesat ekonomike të konsumatorëve”	E pranuar pjesërisht	Largimi i dispozites në fjalë ka qenë (që nga fillimi/inicimi) dhe është edhe insistimi nga/i strukturave kompetente/prezente të BE-s në Kosove (respektivisht atyre nga Brukseli), dhe prandaj, në këtë kontekst, largimi dispozites/ave në fjal, në kontekstin e propozimit nga autoritetet e BE-s, vec se figuron si e tillë në Draft Koncept Dokument.
OJQ – INDEP	INDEP propozon që gjithashtu tek pjesa e Rekomandimeve në faqe 38, të shtohet rekomandimi	E refuzuar	Qështja e rregullimit dhe/apo modifikimit të etiketes perkon me

	<p>në vijim: “Rekomandimi 7: Të obligohet etiketë e posaçme për produkte potencialisht të dëmshme për shëndetin”.</p>		<p>‘Rregulloren per Etiketimin, Prezantin dhe Reklamimin e Produkteve Ushqimore (Nr.09/2013)’. Plotësimi dhe ndryshimi i kesaj Rregulloreja, qe nga viti 2016 perkon me Autoritetin e Ushqimit dhe Veterinaris (AUV). Kështu eshte vendosur edhe zyrtarisht (atëkohe) pasi që eshte konsideruar se kemi të bejm me ‘cilesin ushqimore’.</p>
OJQ - INDEP	<p>INDEP propozon që gjithashtu tek pjesa e Rekomandimeve në faqe 38, të shtohet rekomandimi në vijim: “Rekomandimi 8: Të obligohen subjektet ekonomike që të mbajnë regjistra të garancive dhe mbulesës së garancisë“</p>	E pranuar pjesërisht	<p>Kjo qështje duhet të definohet pasi që ka të bëjë gjithashtu me Ligjin per Auditim dhe/apo Ligjin për ATK. Në cilesin e konsumatorit, rekomandohet që gjithëher të posedohet dhe ruhet garancioni dhe/apo kontrata për produktin e blerë.</p>
OJQ - INDEP	<p>INDEP propozon që gjithashtu tek pjesa e Rekomandimeve në faqe 38, të shtohet rekomandimi në vijim: “Rekomandimi 8: Të përcaktohet një e drejtë universale për kthim të produkteve brenda një kohe të caktuar pavarësisht nëse kontrata është në distancë apo jo”.</p>	E pranuar pjesërisht	<p>Kjo qështje duhet të definohet pasi që një e ‘drejt universale’ duhet definuar në terma shoqëror, kjo sidomos pasur parasysh që tregu i BE-s (drejt kujt synojnë në përgjithësi edhe politikat e R. se Kosoves), karakterizohet gjithashtu mbi parimin si ‘treg i lir dhe i mbështetur në kokurrencë’.</p>
OJQ - INDEP	<p>INDEP propozon që gjithashtu tek pjesa e Rekomandimeve në faqe 38, të shtohet rekomandimi në vijim: “Rekomandimi 9: Të sigurohet që konsumatorëve u ofrohen mundësitë për zgjidhje të mosmarrëveshjeve përmes formave alternative si ndërmjetsimi”</p>	E refuzuar	<p>Qështja e rregullimit dhe/apo modifikimit të Ligjit për Ndërmjetësim, në domeinin e kujt eshte edhe ‘Zgjedhja Alternative e Kontesteve për Konsumator’, që nga viti 2020 perkon me Ministrin e Drejtesisë. Kështu është vendosur edhe zyrtarisht (atëkohe), pasi ishte inicuar si Ligj i veçantë nga DMK.</p>

OJQ - INDEP	<p>INDEP propozon që gjithashtu tek pjesa e Rekomandimeve në faqe 38, të shtohet rekomandimi në vijim:</p> <p>“Rekomandimi 10: Të sigurohet që konsumatorëve u ofrohet opsioni i mbrojtjes së identitetit të tyre në rastet kur raportohen shkelje të përgjithshme të të drejtave të konsumatorëve”.</p>	E pranuar pjesërisht	<p>Opsioni i mbrojtjes së identitetit të konsumatorve në rastet kur raportohen shkelje të përgjithshme të të drejtave të tyre, vec se është (ka qenë që nga fillimi) opsion të cilin mund të zgjedhin konsumatorët. Kjo të pakten kur raportohen shkeljet përmes Departamentit për Mbrojtjen Konsumatorit.</p>
OJQ - INDEP	<p>INDEP propozon që gjithashtu tek pjesa e Rekomandimeve në faqe 38, të shtohet rekomandimi në vijim:</p> <p>“Rekomandimi 11: Të thjeshtëzohet gjuha e Ligjit dhe të ketë qartësi në mes të dispozitave në mënyrë që të ulen dykuptimësitë dhe të përmirësohen referencat e gjobave me shkeljet”</p>	E pranuar pjesërisht	<p>Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit ka të bëjë gjithashtu me ekspozimin e 9 direktivave të BE-s (cilesuar në nivel të lart nga vet ekspertët e BE-s) që dine te rezultojë edhe me gjuhë byrokratike ndonjeher. Në këtë kontekst vërejtjet duhen të jenë ma specifike ndoshta. Qështja e ‘gjobave dhe shkeljeve’ paraqet një prej qeshtjeve prioritare të ketij koncepti dokumenti.</p>
OJQ - INDEP	<p>INDEP propozon që gjithashtu tek pjesa e Rekomandimeve në faqe 38, të shtohet rekomandimi në vijim:</p> <p>“Rekomandimi 12: Të sigurohet me Ligj që një pjesë e buxhetit të Ministrisë përgjegjëse do të alokohet në baza vjetore për fushata vetëdijësuese për të drejtat e konsumatorëve”</p>	E pranuar pjesërisht	<p>Një pjesë e buxhetit të MINT gjithëher alokohet në baza vjetore për fushata vetëdijësuese për të drejtat e konsumatorëve (me shume apo me pak, në varesi të politikave Qeveritare). Gjithsesi, kjo nuk paraqet një qështje që mund të parashikohet përmes Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit, sepse një gjë e tillë, duhet të jetë në kundërshtim me Ligje përkatese (sikurse ai i buxhetit), njëherësh parimet e administratës publike.</p>